



**VENDIM**

*Nr. 26, Datë 15.02.2017*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË  
PËRPUTHSHMËRISË**

Në mbështetje të neneve 16, pika 7, dhe 47 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.02.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për miratimin e draftit të Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-S.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**